



---

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 339/3 Prot.

Tiranë, më 26.04.2019

#### V E N D I M

Nr.42, Datë 26. 04. 2019

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshëmrisë në administrim shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshëmrisë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

#### VËREJ SE:

Me vendimin nr. 96, datë 03.12.2018 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrim shërbimit civil, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër dhe Fushë - Krujë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të

shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes me nr. 874/1, datë 03.12.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 874/3, datë 03.12.2018, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër”, i është njoftuar subjektit të mbikëqyrur.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore përfshihen për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas lidhjes nr. 1, (me numër rendor 78), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 338/1 prot., datë 12.03.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, me shkresën nr. 16 prot., datë 05.04.2019, ka dërguar pranë Komisionerit projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, të dërgojë formularët e përshkrimit të punës, pranë Departamentit të Administratës Publike, për të marrë edhe miratimin e njësisë përgjegjëse dhe më tej t'i depozitojë ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.
3. Duhet të merren masat për plotësimin e dosjeve individuale të personelit sipas konstatimeve në raportin e mbikëqyrjes, në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Për këtë vendim të njoftohet Qendra e Transferimit të Teknologjive, Shkodër, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamenti i Administratës Publike.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONERI

**Pranvera STRAKOSHA**